



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20 dhjetor 2013
Nr.ref.:RK528/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI79/13

Parashtrues

Sokol Haziraj

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. Mlc. nr. 217/2010, të datës 15 prill 2013 dhe të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Ac.nr.240/2010, të datës 14 maj 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi

1. Kërkesa është parashtruar nga Sokol Haziraj (parashtruesi), me vendbanim në Prishtinë, i përfaqësuar nga Naser Peci, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Mlc. nr. 217/2010, të 16 prillit 2013 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut Ac.nr.240/2010, të 14 majit 2010.
3. Parashtruesi e ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (Rev.Mlc.nr. 217/2010) më 13 maj 2013.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimeve të kontestuara, përkritazi me pretendimin e parashtruesit për shkeljet e të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

5. Neni 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (tutje, Kushtetuta), neni 22 dhe 47 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (tutje, Ligjit) dhe rregulli 56.2 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (tutje, Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 5 qershor 2013, parashtruesi parashtrroi kërkesë në Gjykatë.
7. Më 20 qershor 2013, Kryetari e caktoi gjyqtarin Altay Suroy si Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
8. Më 9 korrik 2013, Sekretariati e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe në të njëjtën kohë kërkoi dëshminë me të cilën vërtetohet se pala e ka autorizuar avokatin për përfaqësim në Gjykatë.
9. Më 19 korrik 2013, parashtruesi dorëzon dëshminë mbi autorizimin e avokatit për përfaqësimin e palës në Gjykatë.
10. Më 22 korrik 2013, Sekretariati e njoftoi Gjykatën Supreme të Kosovës për regjistrimin e kërkesës.
11. Më 4 shtator 2013, Gjykata kërkoi nga parashtruesi që të sjellë dokumentin origjinal të ankesës së tij për Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.
12. Në të njëjtën ditë, Sekretariati kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë të vërtetojë nëse parashtruesi kishte bërë ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë në lidhje me lëndën C. nr. 397/06.

13. Më 6 shtator 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë e dorëzoi përgjigjen në Gjykatë.
14. Më 10 shtator 2013, parashtruesi e dorëzoi përgjigjen në Gjykatë.
15. Më 18 tetor 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

16. Më 25 prill 2008, parashtruesi, në cilësinë e ndërhyrësit, përmes përfaqësuesit të tij, paraqet parashtrësë në Gjykatën Komunale në Prishtinë, me të cilën propozon që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit J.G. kundër të paditurve N.V. dhe N.G. me të cilën është kërkuar vërtetimi i kontratës për shitblerjen e paluajtshmërisë të ngastrave kadastrale nr. 653/1 dhe nr. 653/2 në vendin e quajtur “Novo Lojze”, Komuna e Prishtinës, e lidhur në Prishtinë, më 10 tetor 1996, në mes të J.G. dhe N.V., të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë dhe se e njëjta të shpallet nule.
17. Parashtruesi kishte përkrahur në tërësi pretendimet e paditësit J.G. në këtë rast, sipas të cilit, kontrata e lidhur ndërmjet të autorizuarit të tij N.G. si shitës dhe N.V. si blerëse është bërë pas revokimit të autorizimit, i cili është vërtetuar në Gjykatën Komunale, VR. nr. 4896/96, të 14 gushtit 1996 dhe se për këtë është njoftuar i autorizuari.
18. Parashtruesi kishte pretenduar se një pjesë të kësaj prone prej 0.05,00 ha e kishte blerë në vitin 1991, përmes kontratës, nga J.G., për çka ka paguar çmimin kontraktues dhe ka hyrë në posedim të asaj pjese, të cilën e ka shfrytëzuar pa pengesa deri në vitin 2006. Sipas tij, kjo e bën fiktive kontratën ndërmjet N.G. dhe N.V. në raport me të, sipas nenit 66 të Ligjit mbi marrëdhëniet detyrimore.
19. Më 22 dhjetor 2009, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktgjykimin C. nr. 397/2006, pas vërtetimit të gjendjes faktike në shqyrtimin kryesor, e refuzon si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe në të njëjtën kohë refuzohet si i pabazuar *“propozimi i palës ndërhyrëse, Sokol Haziraj nga Prishtina, që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar”* pasi që *“nuk ka mundur ta vërtetojë faktin se pala ndërhyrëse, Sokol Haziraj nga Prishtina, ka hyrë në posedim të një pjese të paluajtshmërisë lëndore kontestuese sipas kontratës së shitblerjes të përpiluar në Prishtinë më 10 shtator 1991, në mes të tij dhe paditësit J.G.”*
20. Më 3 shkurt 2010, parashtruesi paraqet ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale (C. nr. 397/2009) për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, konkretisht shkelje të nenit 66 dhe 88 të LMD-së.
21. Ndaj të njëjtit Aktgjykim, edhe paditësi J.G. kishte paraqitur ankesë.
22. Më 15 maj 2010, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin AC. nr. 240/2010 kishte refuzuar ankesën e paditësit J.G. si e pabazuar për shkak se:

“gjendja faktike pranë Gjykatës Komunale është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, meqenëse nuk ka pasur shkelje qenësore për të cilat kjo gjykatë vëren sipas detyrës zyrtare dhe se e drejta materiale është aplikuar në mënyrë të drejtë, ankesa e paditësit u refuzua kurse aktgjykimi i atakuar u vërtetua konform nenit 195 paragrafi 1 pika d) të LPK-së.”

23. Më 21 korrik 2010, parashtruesi paraqet revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, për shkak të shkeljeve thelbësore të procedurës kontestimore dhe zbatim të bazuar të së drejtës materiale. Sipas tij, Gjykata e Qarkut nuk ka vendosur fare për ankesën e ndërhyrësit dhe se *“në pajtim me nenin 190 të LPK-së gjykata e shkallës së dytë ka qenë e detyruar të vendosë për ankesën në seancën e trupit gjykues ose në bazë të shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore. Për ankesën e ndërhyrësit, gjykata e shkallës së dytë nuk ka vendosur as në njërën, e as në mënyrën tjetër, andaj edhe ka bërë shkelje nga neni 182 par.1 i LPK-së, që është shkak për revizion, i përcaktuar me nenin 214 paragrafi 214.1 pika (a) i LPK-së.”*
24. Kundër të njëjtit aktgjykim, paditësi J.G. kishte paraqitur revizion.
25. Më 16 prill 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Rev. Mlc. nr. 217/2010, kishte hedhur poshtë si të palejuar revizionin e parashtruesit ngase *“i njëjti është paraqitur kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë në pjesën që ka të bëjë me ndërhyrësin në procedurë kundër të cilit aktgjykim në kuptim të nenit 211.1 të LPK-së, nuk lejohet revizioni. Në shkresat e lëndës nuk ka prova se ndërhyrësi në procedurë ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë, e një provë të tillë nuk e ka paraqitur as me revizion.”*

Pretendimet e parashtruesit

26. Parashtruesi pretendon shkelje të neneve 31 dhe 32 të Kushtetutës, pasi që *“ankesa e tij nuk ishte shqyrtuar fare”* në Gjykatën e Qarkut. Ndërsa, Gjykata Supreme e kishte hedhur poshtë revizionin e tij si të palejuar *“me arsyetimin se më parë nuk ishte ushtruar ankesë.”*
27. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që të *“aprovtojë kërkesën si të pranueshme dhe të anulojë Aktgjykimin Rev. Mlc. nr. 217/2010, të 14 prillit 2013.”*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

28. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykatës i nevojitet, së pari, të shohë nëse parashtruesi i plotëson kriteret e pranueshmërisë të parapara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
29. Neni 113 (7) i Kushtetutës përcakton se:

7. “Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

30. Për më tepër, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit i cili përcakton se:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve...”

31. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi ka kërkuar mbrojtjen e të drejtave të tij pranë Gjykatës Komunale dhe të Qarkut dhe përfundimisht pranë Gjykatës Supreme të Kosovës. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme më 13 maj 2013 ndërsa Kërkesën në Gjykatë e ka parashtruar më 5 qershor 2013, që nënkupton se kërkesa është parashtruar në pajtim me dispozitën e lartcekur.

32. Për më tepër, rregulli 36 (1) i Rregullores përcakton se:

(1) “Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

(c) Kërkesa nuk është qartazi e pabazuar”

33. Tutje, sipas rregullit 36 (2), Gjykata do të refuzojë një Kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

b) “faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;

....

d) Kur parashtruesi nuk argumenton në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”

34. Gjykata, po ashtu, i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh që: *“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.”*

35. Përkitazi me shterimin e mjeteve efektive juridike, Gjykata ka kërkuar sqarim nga Gjykata Themelore në lidhje me paraqitjen e kësaj ankese, e cila në përgjigjen e saj sqaron se *“lëndën civile, C. nr. 397/2006, e kemi dërguar sipas ankesës në Gjykatën e Apelit më 1 korrik 2013”*, që korrespondon me 25 ditë pasi që parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën e tij në Gjykatë.

36. Nga përgjigja e Gjykatës Themelore duket se lënda është ende në shqyrtim nga gjykatat e rregullta.

37. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike, siç është interpretuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (shih, nenin 53 të Kushtetutës), është që t’ua ofrojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë edhe Gjykatën, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi ligjor i Kosovës do të sigurojë mjet efikas ligjor kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese (shih, Rasti KI 41/09, parashtruesi i kërkesës AAB/RIINVEST Universiteti SH.P.K, Prishtinë, Aktvendim i 27 janarit 2010; gjithashtu, *mutatis*

mutandis, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës nr. 25803/94, Vendim i 28 korrikut 1999).

38. Në rastin konkret, parashtruesi pretendon se gjykatat e rregullta nuk e kanë shqyrtuar fare ankesën e tij duke bërë shkele të neneve 31 dhe 32 të Kushtetutës dhe kërkon që Gjykata “*të anulojë Aktgjykimin Rev. Mlc. 217/10.*”
39. Gjykata vëren se Gjykata Supreme e kishte hedhur poshtë revizionin e parashtruesit kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë si të palejuar, për shkak se parashtruesi nuk kishte paraqitur dëshmi për dorëzimin e ankesës për Gjykatën e Qarkut kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë në lidhje me lëndën C. nr. 397/2006.
40. Sa u përket pretendimeve në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme (Rev. Mlc. nr. 217/2010), me të cilin refuzohet si i palejuar revizioni i parashtruesit, Gjykata tërheq vërejtjen se nuk mund të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e instancave më të ulëta dhe Gjykata Supreme, përveç dhe për aq sa ato të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria). Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], Nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1;).
41. Prandaj, Gjykata vetëm mund të shqyrtojë nëse procedurat, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, *mutatis mutandis*, Raporti i Komisionit Evropian për të drejtat e njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa nr. 13071/87, 10 korrik 1991).
42. Gjykata vëren konstatimin e Gjykatës Supreme në Aktgjykimin e saj (Rev. Mlc. 217/2010) se “*nuk ka prova se ndërhyrësi në procedurë ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimin të shkallës së parë, e një provë të tillë nuk e ka paraqitur as me revizion*”, ndërsa, në anën tjetër, parashtruesi, gjithashtu, nuk ka arritur që të dorëzojë në Gjykatë dokumentin origjinal të ankesës, të cilën ai pretendon se e ka bërë. Në përgjigjen e tij ndaj kërkesës së Gjykatës për dorëzimin e ankesës origjinale si dëshmi, parashtruesi shpreh se “*kopja e vetme origjinale e ankesës të cilën e kisha unë në cilësinë e të autorizuarit të ndërhyrësit, më është kërkuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë dhe ua kam dorëzuar atyre. Tani posedoj vetëm kopjen.*”
43. Rrjedhimisht, parashtruesi as nuk ka arritur të ndërtojë rastin për shkeljen e të drejtave, në të cilat ai thirret dhe as nuk ka paraqitur ndonjë provë që dëshmon shkeljet e pretenduara kushtetuese, (shih, Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Vendimi i GJEDNJ-së mbi pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të 31 majit 2005).

44. Në tërësi, Gjykata vëren se Kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë as mbi bazën e pranueshmërisë as mbi bazën e meritave sepse parashtruesi ka dështuar të provojë se me vendimet e kontestuarra i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me kushtetutë.
45. Përfundimisht Gjykata konstaton se Kërkesa është qartazi e pabazuar dhe si e tillë e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, dhe në pajtim me rregullin 36 (2) b) dhe d) si dhe rregullin 56.2 të Rregullores, më 18 tetor 2013,

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si ta papranueshme;
- II. Ky vendim t'u komunikohet palëve dhe të botohen në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani